



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
— FERIZAJ —

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof. As. Dr. Samet Dalipi

Nr. Prot.: 1417/21; Datë: 21.05.2021

Në bazë të nenit 22 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Këshilli Drejtues i UShAF, në mbledhjen e mbajtur më 21.05.2021, mori

V E N D I M

- I. Miratohet Rregullorja kundër ngacmimeve seksuale në UShAF.
- II. Vendimi hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit të tij.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i UShAF për qëllim të harmonizimit të akteve të brendshme me Statutin e UShAF, pas elaborimit të draft rregullores në fjalë, në mënyrë unanime vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Këshillit Drejtues të UShAF;
2. Arkivit të UShAF;

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof. As. Dr. Samet Dalipi



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
— FERIZAJ —

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof.As.Dr. Samet Dalipi

Nr. Prot.: 1417/21, Datë: 21.05.2021

Në mbështetje të nenit 22 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Këshilli Drejtues i UShAF, në mbledhjen e mbajtur me datë 21.05.2021 miratoi

RREGULLOREN KUNDËR NGACMIMEVE SEKSUALE NË UShAF

Parimet e përgjithshme

Ngacmimi dhe ngacmimi seksual janë në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë mbi bazat e gjinisë, seksit dhe identitetit gjinorë dhe përbëjnë diskriminim në bazë të gjinisë. Si forma të shkeljes së drejtave të njeriut, ato duhet të jenë të ndaluara dhe duhet të jenë subjekt i përgjegjësive efektive institucionale si dhe dënimeve të efektshme, proporcionale dhe bindëse.

UShAF është i përkushtuar të ndërtojë ambient të sigurt dhe të lirë nga diskriminimi për studentët, personelin akademik dhe jo-akademik, të afirmojë të drejtat e individëve në vendin e punës si dhe në mjedise arsimore.

Në pajtim me Statutin e UShAF, studentët, personeli akademik dhe jo-akademik, kanë për detyrë që të respektojnë, barazinë gjinore, mos diskriminimin, parimet e ndershmërisë, Kodin Etik, reputacionin e universitetit, si dhe të kultivojnë, promovojnë frymën e humanizmit dhe gjithëpërfshirjes.

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1
Objekti

Kjo Rregullore është në funksion të parandalimit dhe trajtimit të rasteve të ngacmimeve seksuale, promovimit të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit në UShAF.

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është:

- a) të ofrojë mjedis të sigurt, të lirë, ku të gjithë të ndihen të barabartë në vendin e punës dhe në mjediset arsimore, pavarësisht dallimeve gjinore;
- b) të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi në baza gjinore;
- c) të përcaktojë masa të sakta lidhur me përgjigjen efektive dhe të menjëhershme në trajtimin e ngacmimeve seksuale në UShAF;
- d) të përcaktojë masa afirmative për individët dhe grupet që janë apo mund jenë të prekura nga kjo dukuri.

Neni 3 Përkufizimet

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. *Ngacnimi seksual* nënkupton çfarëdo forme të sjelljes së padëshiruar verbale, jo verbale, apo fizike me natyrë seksuale, me qëllim apo pasojë prekjen apo shkeljen e dinjitetit të një personi, dhe për të krijuar një mjedis frikësues, armiqësor, degradues, poshtërues apo fytes; (Neni 1.12 nga Ligji për Barazi Gjinore i Kosovës).
2. *Barazi gjinore* është ushtrimi i plotë dhe i barabartë i burrave dhe grave i të drejtave të tyre të njeriut. Është mosprania e diskriminimit në bazë gjinore në mundësitë, ndarjen e burimeve apo përfitimeve si dhe qasjen në shërbime (Ligji i Kosovës për Barazi Gjinore, Neni 1.1).
3. *Diskriminim i drejtpërdrejtë* konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.
4. *Diskriminim i tërthortë* konsiderohet kur, një dispozitë, kriter apo praktikë e paanshme në dukje e vë, e ka vënë apo do ta vë personin në pozitë të pabarabartë krahasuar me të tjerët, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, përveç në rastet kur dispozita, praktika apo kriteri i tillë mund të arsyetohet në pikëpamje objektive me një qëllim legjitim, dhe mjetet për arritjen e qëllimit janë të përshtatshme dhe domosdoshme” (neni 4, paragrafët 1.1 dhe 1.2 Ligji i Kosovës për Mbrojtje nga Diskriminimi).
5. *Viktimizimi* konsiderohet diskriminim mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, dhe ndodhë kur personi përjeton trajtim të pafavorshëm apo pasoja negative si reagim ndaj ankimit apo mos ankimimit (procedurave të filluara) apo veprimeve me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë, ose në rastet kur personi i tillë ofron

informacione, dëshmi apo ndihmë në lidhje me ankesën ose procedurën në rast të diskriminimit,

Neni 4

Përgjegjësitë e UShAF për mbrojtjen e studentëve, personelit akademik dhe jo-akademik nga diskriminimi dhe ngacmimi seksual

1. Çdo diskriminim dhe ngacmim seksual në vendin e punës dhe ambientet arsimore të UShAF është i ndaluar.
2. Universiteti detyrohet:
 - a) të marrë masa parandaluese, të informojë, edukoj dhe komunikojë me studentët, personelin akademik dhe jo-akademik në lidhje me parandalimin dhe sanksionimin e diskriminimit dhe ngacmimit seksual në vendin e punës dhe ambientet arsimore;
 - b) të zbatojë masa (sanksione) disiplinore bazuar në Rregulloren për masat dhe procedurat disiplinore të personelit akademik të UShAFë dhe aktet tjera relevante në fuqi;
 - c) i bën të dukshme informatat lidhur me përmbajtjen e kësaj rregulloreje në hapësirat e fakulteteve, njofton studentët, personelin akademik dhe jo-akademik për ku ushtrohen raportimet për rastet e ngacmimeve si dhe edukon mbi masat parandaluese, raportuese dhe hetuese. Po ashtu informatat duhet të jenë lehtë të qasshme për studentë edhe në ueb faqet zyrtare të fakulteteve si dhe duhet ofruar numri kontaktues anonim për këshilla dhe referim të mëtutjeshëm.
 - d) të merr masat e duhura ligjore për ndalimin e vazhdimin të diskriminimit dhe ngacmimit seksual, pas denoncimit me shkrim të rastit nga pala ankuese;

Neni 5

Ngacmimi seksual-shkelja e dinjitetit

1. Duke u bazuar në definicionin mbi ngacmimin seksual, shkelja e dinjitetit përcaktohet si veprim i cili:
 - 1.1. zvogëlon vet respektin e personit duke e vendosë atë në pozitën inferiore dhe në varësi (poshtërim);
 - 1.2. trajton personin si instrument ose si mjet për arritjen e qëllimit dhe interesit (objektivizim);
 - 1.3. zvogëlon vlerën e cila karakterizon çdo person si anëtar të barabartë dhe me vlerë të racës njerëzore (degradim);
 - 1.4. privon personin nga vlerat e tij/saj humane (dehumanizim).

S. O.

Neni 6 Format e shfaqjes së ngacmimit seksual.

1. **Ngacmimin Verbal** –konsiston në komente mbi trupin, shaka, pyetje provokuese, komente të natyrës seksuale, shprehje fyese, epitete poshtëruese, formulime nënçmuese ose shpërdorime tjera verbale si në vijim:
 - 1.1. inkurajimi për përfitime intime seksuale;
 - 1.2. letrat, telefonatat ose materialet e natyrës seksuale;
 - 1.3. inkurajim për takime intime apo private;
 - 1.4. komente, pyetje, barsoletat të natyrës seksuale;
 - 1.5. përdorimi i epiteteve jo adekuate etj. janë komente seksuale;
 - 1.6. të drejtuarit e diskutimeve mbi detyrat zyrtare drejtë temave seksuale;
 - 1.7. insinuatat ose tregimet seksuale;
 - 1.8. pyetjet mbi fantazitë, prirjet dhe përvojat seksuale;
 - 1.9. pyetjet personale intime mbi jetën shoqërore ose seksuale;
 - 1.10. komentet seksuale mbi veshjet, anatominë ose pamjen e personit;
 - 1.11. gënjeshttrat ose përhapja e fjalëve mbi jetën personale seksuale të personit.

2. **Ngacmimi Jo verbal** - gjeste provokuese me lëvizje dhe prekje provokuese të pjesëve të ndryshme të trupit të personit që provokon ndaj trupit të personit tjetër si në vijim:
 - 2.1. shikimet provokuese dhe gjestet tjera të natyrës seksuale;
 - 2.2. fishkëllimi pas personit;
 - 2.3. imitimi i zërave të shtazëve;
 - 2.4. dërgimi i puthjeve;
 - 2.5. ngacmimi virtual,
 - 2.6. ekspozim të reklamave, fotografive dhe shenjave pornografike, vizatime ose komente seksuale për veshjen, stolitë apo trupin e një individi.

3. **Ngacmimi Fizik** – konsiderohen veprimet si në vijim:
 - 3.1. dhunimi, sulmi seksual ose tentimi;
 - 3.2. masazhim i qafës ose të supeve;
 - 3.3. prekja e teshave, e flokëve ose trupit të personit;
 - 3.4. përqaqim, puthje, përkëdhelje;
 - 3.5. prekja e qëllimshme, përkulja mbi personin;
 - 3.6. vetëkënaqje seksuale në praninë e personit tjetër;
 - 3.7. qëndrimi afër personit apo fërkimi me personin tjetër.

Neni 7 Format e manifestimit të ngacmimit seksual

1. **Quid pro quo** (një favor për një favor).

S.O.

- 1.1. Ka të bëjë me situatat në kuadër të raporteve zyrtare, në rend të parë raporteve në vendin e punës, ku vendimet në interes të personit (viktimë) kushtëzohen me pranimin e propozimeve, kërkesave apo sjelljeve seksuale, të cilat para personit (viktimë) i shtron personi zyrtar me pozitën më të lartë në hierarkinë profesionale dhe ndaj të cilit personi -viktimë është në raport të varësisë. Kërkesë për seks si kushtëzim për pozitë më të lartë, punësim apo për përfitime tjera si;; Presion i vazhdueshëm ose kërkesë për qëllime seksuale;
- 1.2. Quid pro quo forma e ngacmimit seksual konsiderohet:
 - 1.2.1. veprimi me të cilin personi në pozitën më të lartë zyrtare apo profesionale/akademike kushtëzon me shërbime seksuale punësimin, avancimin, rritje të pagës, regjistrim në fakultet, kalim provimi, vlerësimin, ose ndonjë tjetër privilegj ndaj studentit apo për personin në pozitën më të ultë zyrtare apo profesionale/akademike;
 - 1.2.2. kërcënimi i personit (vartësit) me ndërprerjen e kontratës, zhvendosjen, degradimin ose ndonjë llojit tjetër të ndikimit negativ në pozitën e punës apo pozitën profesionale/akademike në rast se vartësi nuk pranon të hyjë apo të vazhdojë raporte seksuale;
 - 1.2.3. premtime ose sigurimi i rritjes se pagës ose avancimit të personit në varësi në këmbim të shërbimeve ose premtimeve për shërbime seksuale;
 - 1.2.4. veprimi përmes të cilit personi në pozitën më të lartë zyrtare apo profesionale/akademike i ofron varësit një detyrë të veçantë apo mundësi për ta dëshmuar vetën, mundësinë e udhëtimeve zyrtare apo pjesëmarrjes në ngjarjet profesionale të rëndësishme për karrierën e tij/saj dhe pret që vartësi këto mundësi të ofruara t'i shpagojë me shërbime seksuale.
2. **Seksualizimi i ambientit (të punës)**
 - 2.1. Ky lloj i ngacmimit seksual nuk përfshinë domosdoshmërisht kërkesa për shërbime seksuale, respektivisht hyrje në raporte seksuale, por është i përqendruar në forma të ndryshme të veprimeve verbale ose jo-verbale të natyrës seksuale të cilat viktimën në mënyrë të drejtpërdrejtë, me qëllim apo pa qëllim, reduktojnë në objekt seksual me çfarë zvogëlohet reputacioni i tij/saj, statusi profesional respektivisht mundësia e zhvillimit profesional. Në këtë lloj të ngacmimit seksual përfshihen veprimet si:
 - 2.1.1. shpërndarje e video incizimeve ose fotografive me përmbajtje pornografike;
 - 2.1.2. dërgimi i letrave sugjестive, shënimeve dhe emailave me përmbajtje të natyrës seksuale;
 - 2.1.3. paraqitja e fotografive ose pllakateve me përmbajtje seksuale në vendin e punës;
 - 2.1.4. barsoletat e pavend dhe të pahijshme ose anekdotat seksuale;
 - 2.1.5. gjestet e pavend të natyrës seksuale;
 - 2.1.6. shikimet sugjестive seksuale, ngulja e syve ofendues, fishkëllima;

S.O.

- 2.1.7. komentet seksuale mbi dukjen, veshjen ose pjesë të trupit;
- 2.1.8. prekja e pavend, masazhimi, pickimi, fërkimi, rrëshqitja mbi personin tjetër.

Neni 8

Kushtëzimi dhe ngacmimi seksual

1. Kushtëzim dhe ngacmim seksual në universitet konsiderohen:
 - 1.1. shprehjet verbale të insinuatave ose përmbajtjeve seksuale (përshkrimi i skenave seksuale etj.);
 - 1.2. ftesa për kafe ose dreke/darkë në situatat kur për personin (viktimën) kjo është e papëlqyeshme;
 - 1.3. ftesë ndaj studentëve ose kolegeve për marrje të materialeve (arsimore ose të punës) në shtëpi ose ndonjë vend tjetër jashtë ambientit të punës;
 - 1.4. insistimi në marrjen e shënimeve personale edhe atëherë kur personi tjetër (viktima) refuzon;
 - 1.5. thirrjet apo mesazhet telefonike pa pëlqim te personit tjetër;
 - 1.6. kufizimi i lëvizjes me mbyllje me çelës i zyrave dhe hapësirave tjera të punës (sallat, etj.).
 - 1.7. insistimi në kryerjen e punëve në fund të orarit të punës ose kur janë hapësirat e punës të zbrazura;
 - 1.8. ngacmimi fizik seksual .

Neni 9

Denoncimi i rrejshëm i ngacmimeve seksuale

1. Deklarimi apo denoncimi i rrejshëm është vepër penale e ndëshkueshme me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.
2. Ndaj personit përgjegjës, për deklaram apo denoncim të rrejshëm ngacmimit seksual, do të iniciohet procedurë penale pranë organeve shtetërore kompetente, si dhe nga Komisioni etik i Universitetit do të ndërmerren masa të rënda ndëshkimore, në përputhje me Rregulloren për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të UShAF.

Neni 10

Edukimi për parandalimin e diskriminimit dhe ngacmimeve seksuale

1. Universiteti, siguron mjedis i cili përkrahë dijen, praktika dhe politika, për të eliminuar ngacmimin seksual dhe të gjitha format e diskriminimit.
2. Universiteti, në mënyrë të veçantë njësitë akademike, sipas fushave përkatëse, ndërmarrin masa për kryerjen e studimeve në fushën e barazisë gjinore, diskriminimit, ngacmimeve të natyrës seksuale ose e përfshijnë atë në studimet e kryera, për të siguruar materiale me informacionin përkatës, që shërben për vetëdijesimin dhe parandalimin e dukurive negative.

S.O.

3. Qendra për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore (kur fillon të funksionoj), ofron shërbime këshilluese për personelin akademik, jo-akademik dhe për studentët në lidhje me diskriminimin dhe ngacmimet seksuale.
4. Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie (kur fillon të funksionoj), harton dhe zbaton programin e trajnimit për parandalimin e diskriminimit dhe ngacmimeve seksuale, i obligueshëm për të gjithë studentët, personelin akademik dhe jo-akademik. Trajnimet ofrohen me anë të platformës elektronike të UShAF-së dhe zbatohen sipas orarit të publikuar në fillim të çdo viti akademik. Në rast të përditësimit të trajnimit, pas tri viteve, ndjekja e trajnimit është e obligueshme.
5. Studentët të cilët pranojnë në UShAF, gjatë semestrit të parë, janë të obliguar ta përfundojnë trajnimin me sukses. Pas përfundimit të trajnimit, studenti do të pajiset me certifikatë të cilën do ta dorëzojë në shërbim të studentëve të njësisë përkatëse akademike për ruajtje në dosje personale.
6. Dorëzimi i certifikatës së trajnimit është kusht për regjistrim të semestrit vijues.
7. Personeli akademik dhe jo-akademik, obligohet të përfundojnë trajnimin me sukses. Pas përfundimit të trajnimit, personeli do të pajiset me certifikatë. Personeli akademik, certifikatën do ta dorëzojë për ruajtje në dosje personale në administratën qendrore të UShAF, ndërsa personeli jo-akademik certifikatën do ta dorëzojë tek menaxheri i personelit në Administratën qendrore.
8. Në rast se personeli nuk e përfundon trajnimin brenda periudhës së caktuar, ndaj tij/saj do të iniciohet procedurë disiplinore.
9. Vlerësimi dhe krijimi i infrastrukturës (fizike dhe digjitale) dhe hapësirave universitare nga aspekti i përfshirjes dhe barazisë gjinore;
10. Rektorati dhe njësitë akademike, obligohen të ofrojnë qasje të lehtë studentëve, personelit akademik dhe jo-akademik, në informata dhe aktet ligjore dhe nënligjore të cilat e trajtojnë ngacmimin seksual.

Neni 11

Themelimi dhe përbërja e Komisioneve të Etikës në njësi akademike

1. UShAF obligohet të themelojë Komisionin Etik të Universitetit.
2. Komisioni Etik shqyrton rastet të cilat kualifikohen si shkelje të lehta etike apo disiplinore.

S.O.

3. Këshilli Etik i UShAF, obligohet që jo më larg se 60 ditë nga miratimi i kësaj rregulloreje të nxjerrë Rregulloren e punës dhe të përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit Etik.

4. Komisioni Etik i njësisë akademike do të ketë përbërjen si në vijim:

Pesë anëtarë nga njësitë akademike me mandat katër vjeçar dhe një përfaqësues i Parlamentit studentor me mandat një vjeçar dhe një nga administrata me mandat katër vjeçar.

Një (1) përfaqësues i nominuar nga organizatat joqeveritare që janë aktiv në fushën e barazisë gjinore dhe kundër diskriminimit.

2. Kryetari i Këshillit të Etikës zgjidhet nga anëtarët e Këshillit dhe ka mandat katër vjeçar.

3. Këshilli i Etikës mund të nxjerrë Rregulloren e punës, me të cilën do t'i rregullojë çështjet të cilat nuk janë paraparë me këtë Kod.

4. Mandati i anëtarëve të Këshillit është i lidhur me mandatin e organit i cili e zgjedh.

Neni 12

Procedura e raportimit të ngacmimit seksual

1. Çdo ngacmim seksual duhet të raportohet nga denoncuesi/ja, në kopje të fortë dhe elektronike tek zyrtari kryesor administrativ (stafi jo akademik dhe studentët) ndërsa te Prorektori për mësim (stafi akademik) përderisa nuk plotësohet infrastruktura ligjore me personelin për të drejtat e njeriut pranë Qendrës për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në UShAF (në tekstin e mëtejme (QDNJBGJ));

2. Denoncimi i ngacmimit seksual duhet të jetë i bazuar dhe i qartë, që provon shkeljen e kësaj Rregulloreje nga ana e të denoncuarit.

3. Denoncimi i ngacmimit seksual, raportohet në një periudhë jo më larg se një (1) vit nga ndodhja e ngacmimit.

4. Zyrtari/ja për të drejtat e njeriut, e protokollon rastin e denoncuar në një libër të veçantë për ngacmime seksuale dhe e plotëson një formular standard me informacione relevante për rastin;

5. Të dhënat e denoncuesit duhet të mbesin në konfidencialitet të plotë;

6. Zyrtari/ja, në afat prej 24 orësh pune, dosjen e denoncuesit të kompletuar e përcjellë tek kryesuesi i Komisionit Etik.

S . D .

7. Këshilli Etik, nëse konstaton se rasti i raportuar kualifikohet si shkelje e lehtë, pas shqyrtimit të rastit, shqipton masën ndëshkimore në përputhje me Rregulloren për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të UShAF.
8. Në të gjitha rastet kur Këshilli Etik, konstaton se rasti i paraqitur përbën shkelje të rëndë (siç përcaktohet me këtë rregullore, Kodin Etik dhe me Rregulloren për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të UShAF), të njëjtin e referon te Komisioni disiplinor;
9. Komisioni mund të shqiptojnë masa të lehta (të parapara në Rregulloren për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të UShAF);
10. Këshilli i Etikës është autoritet i cili i propozon Komisionit disiplinor, masa disiplinore ndaj studentëve, personelit akademik dhe jo-akademik për shkeljet e Kodit të Etikës në pajtim me procedurat disiplinore të përcaktuara në Rregulloren për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të UShAF;
11. Vendimi përfundimtar për shkelje të rënda të kësaj Rregulloreje, merret nga Senati i UShAF.
12. Barra e provës bie mbi palën e denoncuar për ngacmim seksual (t'i referohet ligjit kundër ngacmimit-diskriminimit).

Neni 13 Masat për shkeljet disiplinore

Masat për shkelje të Kodit të Etikës dhe shkelje disiplinore janë të parapara në në Kodin e Etikës.

V. Dispozitat përfundimtare Neni 14

1. Zbatimi i kësaj Rregulloreje mbikëqyret nga Këshilli Drejtues i UShAF.
Interpretimin e kësaj Rregulloreje e jep Këshilli Drejtues.
2. Për çështjet të cilat nuk janë paraparë me këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë, Ligjit të Punës, Ligjit për barazi gjinore; Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi, Kodi Penal i Kosovës; Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, Statutit të UShAF, Kodit të Etikës dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 15 Hyrja në fuqi


Kjo Rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Këshilli Drejtues.

S. O .

Neni 16

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet rregullorja kundër ngacmimeve seksuale në UShAF, nr. 315/19, dt. 22.02.2019.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues i UShAF


Prof. As. Dr. Samet Dajipi

